



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-112/01-0000676/25
Data
Date 06.01.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës / Skupština Opštine / Municipality of Assembly

PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

2024

Pasqyra e planit

Parathënie.....	2
Janar.....	5
Shkurt.....	6
Mars.....	6
Prill.....	8
Maj.....	9
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	12
Tetor.....	13
Nentor.....	14
Dhjetor.....	15
Perfundimi.....	15

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për :

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2025, ku Kuvendi i Komunës së Skenderajt planifikon t'i mbaj 11 (njëmbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në

interes të Komunës dhe të qytetarëve të Skenderajt, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Themelon Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete sipas ligjit;
- Funksonalizon komitetet e formuara këshillëdhënëse dhe planifikon raportimin e këtyre komiteteve para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bënë harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente sipas nevojës, siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Dinamika e planit të punës së Kuvendit të Komunës do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit të miratuar në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2025, që përfshin edhe orarin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë program, do të përkujdesen Kryetari, Kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2025.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale dhe komitetet e përhershme përgjegjëse për shqyrtim.

Shtojcë: Plani i punës sipas muajve 2025

Udhëheqësi i Sekretarisë

Jeton Osmani



PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

JANAR

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti i punës së ekzekutivit për vitin 2024		Kryetari i Komunës	10.01.2025	KPF 20.01.2025	31.01.2025	
2.	Miratimi i planit të punës së KKSBB-së.		Kryetari i Komunës	10.01.2025	KPF 20.01.2025	31.01.2025	
3.	Raporti përfundimtar e gjysme vjetorit të parë të vitit shkollor 2024-2025 dhe përgatitjet për gjysmë vjetorin e dytë	DKA	Kryetari i Komunës	10.01.2025		31.01.2025	
4.	Raportet e punës së Komiteteve Konsultative		Kryetari i Komunës	10.01.2025	KPF 20.01.2025	31.01.2025	
5.	Raporti përfundimtar i QKMF-së, Qendrës sociale, dhe shtëpisë së pëlqeve.	DSHMS	Kryetari i Komunës	10.01.2025	KPF 20.01.2025	31.01.2025	
6.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend		Kryetari i Komunës	10.01.2025	KPF 20.01.2025	31.01.2025	
7.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

SHKURT

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1	Bartja e buxhetit të pasqyruar nga viti i kaluar ne vitin aktual.	DEF	Kryetari i Komunës	09.02.2025	KPF 17.02.2025	28.02.2025	
2	Informata për mbrojtje nga zjarri.	DSHP	Kryetari i Komunës	09.02.2025		28.02.2025	
3	Informata për gjendjen në shëndetësi.	DSHMS	Kryetari i Komunës	09.02.2025		28.02.2025	
4	Raporti përfundimtar i zyrës së prokurimit.		Kryetari i Komunës	09.02.2025	KPF 17.02.2025	28.02.2025	
5	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend.		Kryetari i Komunës	09.02.2025	KPF 17.02.2025	28.02.2025	
6							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

MARS

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar dhe realizimi të buxhetit për vitin 2024.	DEF	Kryetari i Komunës	10.03.2025	KPF 17.03.2025	28.03.2025	
2.	Informatë mbi ndërtimet në Komunën e Skenderajt.	DUMA	Kryetari i Komunës			28.03.2025	
3.	Informatë rreth procedurës së legalizimeve të ndërtimeve.	DUMA	Kryetari i Komunës			28.03.2025	
4.	Informate mbi ndarjen e subvencioneve		Kryetari i Komunës			28.03.2025	
5.	Informatë tremujore për sigurinë e ushqimit.	DI	Kryetari i Komunës			28.03.2025	
6.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend.						
7.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

PRILL

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për muajt; janar, shkurt, mars 2025.	DEF	Kryetari i Komunës		KPF 18.04.2025	28.04.2025	
2.	Informatë për gjendjen sociale në komunën e Skenderajt.	DSHMC	Kryetari i Komunës			28.04.2025	
3.	Informatë në lidhje me ndarjen e bursave për vitin 2025.	DKA	Kryetari i Komunës			28.04.2025	
4.	Informatë tremujore në lidhje me punën e Zyrës së Informimit.	ZI	Kryetari i Komunës			28.04.2025	
5.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend		Kryetari i Komunës	10.04.2025	KPF 18.04.2025	28.04.2025	
6.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

MAJ

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë për Qarkoren buxhetore për vitin 2025 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjime publike.	DEF	Kryetari i Komunës	09.05.2025	KPF 19.05.2025	30.05.2025	
2.	Informate mbi realizimin e planit të prokurimit.	ZP	Kryetari i Komunës	09.05.2025		30.05.2025	
3.	Informatë lidhur me zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.	DKRS	Kryetari i Komunës	09.05.2025		30.05.2025	
4.	Trajtimi i çështjeve të tjera të proceduara për Kuvend.		Kryetari i Komunës	11.05.2025		30.05.2025	
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

QERSHOR

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Draft korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2025-2028	DBF	Kryetari i Komunës	09.06.2025	KPF 20.06.2025	30.06.2025	
2.	Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2024.	DBF	Kryetari i Komunës	09.06.2025	KPF 20.06.2025	30.06.2025	
3.	Informatë lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Skenderajt.	DI	Kryetari i Komunës	09.06.2025	KPF 20.06.2025	30.06.2025	
4.	Trajtimi i çështjeve të tjera të proceduara për Kuvend.		Kryetari i Komunës	09.06.2025	KPF 20.06.2025	30.06.2025	
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

KORRIK

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Njoftim për Kuvendin e Komunës lidhur me raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare për vitin 2024.		Kryetari i Komunës	11.07.2025	KPF 21.07.2025	31.07.2025	
2.	Raporti gjashtë mujor i realizimit të buxhetit	DBF	Kryetari i Komunës	11.07.2025	KPF 21.07.2025	31.07.2025	
3.	Informate mbi performancën e Komunës për vitin 2024.	AD	Kryetari i Komunës	11.07.2025		31.07.2025	
4.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024/25.	DKA	Kryetari i Komunës	11.07.2025		31.07.2025	
5.	Informatë gjashtë mujor lidhur me punën e Zyrës së Informimit	ZI	Kryetari i Komunës	11.07.2025		31.07.2025	
6.	Informatë gjashtë mujor për sigurinë e ushqimit	DI	Kryetari i Komunës	11.07.2025		31.07.2025	
7.	Informate mbi gjendjen social ekonomike të Komunës së Skenderajt		Kryetari i Komunës	11.07.2025		31.07.2025	
8.	Informate për përfundimin e vitit shkollor, testi i arritshmërisë dhe testit të maturës.	DKA	Kryetari i Komunës	11.07.2025		31.07.2025	
9.	Raporti gjashtë mujorë i QKMF-së, qendrës sociale, dhe shtëpisë së pëlqeve.	DSHMS	Kryetari i Komunës	11.07.2025	KPF 21.07.2025	31.07.2025	
10.	Trajtimi i çështjeve të tjera të proceduara për Kuvend.		Kryetari i Komunës	11.07.2025	KPF 21.07.2025	31.07.2025	
11.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

GUSHT

- **Muaji i pushimeve verore**

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

SHTATOR

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Shqyrtimi i Draft-Buxhetit për vitin 2026-2027-2028.	DBF	Kryetari i Komunës	10.09.2025	KPF 21.09.2025	29.09.2025	
2.	Informate mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.		Kryetari i Komunës	10.09.2025		29.09.2025	
3.	Informate për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/25	DKA	Kryetari i Komunës	10.09.2025		29.09.2025	
4.	Informate për përfundimin e korrijeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore	DBPZHR	Kryetari i Komunës	10.09.2025		29.09.2025	
5.	Trajtimi çështjeve të tjera të proceduara për Kuvend		Kryetari i Komunës	10.09.2025	KPF 21.09.2025	29.09.2025	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

TETOR

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti nëntë mujor i realizimit të buxhetit	DBF	Kryetari i Komunës	10.10.2025	KPF 23.10.2025	31.10.2025	
2.	Informatë lidhur me nivelin e pastërtisë në qytetin e Skenderajt dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.	DSHP	Kryetari i Komunës	10.10.2025		31.10.2025	
3.	Informatë lidhur me procesin e legalizimit të objekteve.	DUMA	Kryetari i Komunës	10.10.2025		31.10.2025	
4.	Trajtimi i çështjeve të tjera të proceduara në Kuvend.		Kryetari i Komunës	10.10.2025	KPF 23.10.2025	31.10.2025	
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

NËNTOR

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Skenderajt.	DSHMS	Kryetari i Komunës	10.11.2025		28.11.2025	
2.	Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve.	DZHE	Kryetari i Komunës	10.11.2025		28.11.2025	
3.	Informatë lidhur me mbrojtjen e ambientit	DSHP	Kryetari i Komunës	10.11.2025		28.11.2025	
4.	Informatë tremujore për sigurinë e ushqimit	DI	Kryetari i Komunës	10.11.2025		28.11.2025	
5.	Informatë tremujore lidhur me punën e Zyrës së Informimit	ZI	Kryetari i Komunës	10.11.2025		28.11.2025	
6.	Trajtimi i çështjeve të tjera të proceduara për Kuvend		Kryetari i Komunës	10.11.2025	20.11.2025	28.11.2025	
7.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

DHJETOR

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITET ET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Miratimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2025.		Kryetari i Komunës	08.12.2025	KPF 15.12.2025	26.12.2025	
2.	Miratimi i planit të punës së ekzekutivit për vitin 2025.		Kryetari i Komunës	08.12.2025	KPF 15.12.2025	26.12.2025	
3.	Raporti vjetor i Komisionit të Aksionarëve të KRRU "Uniteti"	Komisioni i aksionarëve	Kryetari i Komunës	08.12.2025	KPF 15.12.2025	26.12.2025	
4.	Raporti i vjetor i Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike "Eko Natyra" - Skenderaj	Komisioni i aksionarëve	Kryetari i Komunës	08.12.2025	KPF 15.12.2025	26.12.2025	
5.	Informatë lidhur me mirëqenien sociale: Strehimi familjar, përkujdesja për të moshuarit.	DSHMS	Kryetari i Komunës	08.12.2025		26.12.2025	
6.	Trajtimi i çështjeve të tjera të proceduara për Kuvend.		Kryetari i Komunës		KPF 15.12.2025	26.12.2025	

Përfundim

Plani Vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e seancave të Kuvendit. Duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit Planin e Punës, ata do të kenë një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve që do bëjë ky institucion gjatë vitit 2025, gjithashtu të gjitha datat e mbajtjeve të mbledhjeve të komitetit për politike dhe financa dhe mbledhjeve të Kuvendit janë të ndryshueshme.